



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 Nr 1026 /2011
Data :19.12.2011

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nëni 5 pika c, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nëni 8 si dhe Udhëzimit Administrativ, 17/2009, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

-I- Shkollat Fillore :

1. Shkolla Fillore” Liria” fsh. Pogradjë

- Një mësimdhënësi i lëndës së gjuhës angleze në paralelet e ndara : Llovçë 13 orë, Kokaj 4 orë dhe Sllubicë 4 orë.

2. Shkolla Fillore”Nazim Hikmet” fsh. Dobërçan

- Një bibliotekist , 10 orë
- Një mësimdhënësi i lëndës së edukatës fizike, 20, me plotësim norme në sh.f. Musa Zajmi dhe sh.m.Gjimnazi, për mësim në gjuhën turke

3. Shkolla Fillore”Abdullah Tahiri” fsh. Malishevë

- Një mësimdhënësi i lëndës së gjuhës angleze (zëvendësim- pushim i lehonisë)

4.. Shkolla Fillore “Skënderebeu”fsh. Përlepnice

- Një mësimdhënësi i lëndës së gjuhës angleze në paralelet e ndara në Kmetovc 16 orë.
- Një mësimdhënësi i lëndës së kulturës figurative, 12 orë.

5. Shkolla Fillore “ Bajram Curi” në fsh. Shurdhan

- Një Pastrues

6. Shkolla Fillore “ Vebi Ibrahim” në fsh. Uglarë

- Një mësimdhënësi i lëndës së historisë dhe gjeografisë, 15 orë
- Një pastrues

-II- Shkollat e Mesme

1. Shkolla e Mesme Ekonomike“ Marin Barleti”

- Një mësimdhënësi të lëndës së TIK-ut
- Një rojtar

2. Shkolla e Mesme-Gjimnazi” Zenel Hajdini”

- Një mësimdhënësi i lëndës së gjuhës shqipe

Kushtet e konkursit :

Kualifikimi për mësimdhënësi : përgatitja adekuate profesionale sipas normativit Nr. 19/2009, në mungesë të kandidatëve të cilët kërkohen sipas normativit në fjalë, komisioni do të bëjë një emërim të përkohshëm. Emërimi i tillë do të përfundojë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi, konform nënit 35 paragraf 5 të ligjit për arsimin parauniversitar, nr.04/L-032, nga radha e kandidatëve me kualifikim dhe kushte më të përafërt.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Kualifikimi për vendet e punës të stafit ndihmës : kërkohet që kandidati të ketë përgatitje të mesme shkollore apo fillore.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: Diploma mbi përgatitjen profesionale , kopja e letërnjoftimit, certifikatat për trajnimet e kryera adekuate, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile , me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, si dhe dëshmitë tjera. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen, ndërsa dokumentet origjinale prezantohet në intervistë.

Paga : për shkollat fillore dhe të mesme paga bazë, ndërsa për pozitat e tjera koeficienti sipas përshkrimit të detyrave punuese.

Kohëzgjatja e kontratës: sipas Ligjit të Punës

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit .

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Zbatohet vendimi i lëshuar nga Kryetari i Komunës, nr. 59.2011 i datës 11.02.2011, për luftimin e familjarizimit me rastin e punësimit.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen përmes listës e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.

**Drejtori
Bujar Nevzati**